



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.161, datë 05.07.2022

PËR

“CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR KANDIDATËT QË KANË KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.152, DATË 27.06.2022, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenet 159 pika 1, 161 dhe 190 pika 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në pikat 2-7 të nenit 32 dhe në pikat 7-8 të nenit 48, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Rregullores “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pasi u njoh me relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, për caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin Nr.152, datë 27.06.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin Nr.152, datë 27.06.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
1. Ervisa Hyka, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Relator, zonja Nurihan Seiti.
 2. Genci Mane, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Relator, zoti Ludovik Dodaj.
 3. Elida Hoxhaj, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Relator, zonja Nurihan Seiti.



4. Çlirim Sino, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Relator, zoti Zeqir Hoda .
5. Elion Mustafaj, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Relator, zoti Ludovik Dodaj.
6. Suela Beluli, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Relator, zoti Zeqir Hoda.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

III. U shpall në Tiranë, sot më 05.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR

Alfred Balla

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Bujar Sheshi

ANËTAR

Nurihan Sëiti

ANËTAR

Eloida Coxhi

ANËTAR

Esmeralda Keshi

ANËTAR

Ludovik Dodaj

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Mirela Bogdani